

**Konsultimet mbi draft statusin e KOMRA-së
me organizatat e shoqërisë civile në Osijek dhe në Komunat e Osijekut -
-Baranjës**

**13. korrik 2010.
Volonterski centar, Jägerova 12, Osijek, Kroaci**

Komentet e pjesëmarrësve:

PJESA I - DEFINICIONET

PJESA II – DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

**Artikulli 1.
Definicioni**

Komisioni rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të Drejtave të Njeriut në territorin e ish RSFJ-së është organizatë ndërkombëtare rajonale të cilën e themelojnë shtetet të krijuara pas shpartallimit të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, me qëllim të vërtetimit të fakteve mbi konfliktet e armatosura, krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të Drejtave të Njeriut të kryera në luftërat në territorin e ish Jugosllavisë në periudhën nga 01. Janari 1991 deri më 31. dhjetor 1999.

**Artikulli 2.
Emri**

1. Emri i Komisionit është Komisioni rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të Drejtave të Njeriut në territorin e ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.
2. Shkurtesa e emrit është KOMRA.

**Artikulli 3.
Shenja dhe llogo-ja**

1. KOMRA ka shenjë dhe llogo e cila është pjesë përbërëse e identitetit vizual.

2. KOMRA vendos mbi identitetin e vet vizual.

Artikulli 4.

Selia

Selia e KOMRA-së është në Sarajevë.

Artikulli 5.

Periudha e veprimtarisë

1. Mandati i kohëzgjatjes së KOMRA-së përfshinë periudhën prej dy vitesh, pas periudhës përgatitore gjashtë mujore.
2. KOMRA mund të zgjas mandatin e saj më së shumti për gjashtë muaj.

Koment:

Dy vjet, tre vite, fatkeqësisht të gjitha ato çka kanë ndodhur dhe si kanë ndodhur, mendoj se nuk mjafton. (Branislav Vorkapiq, Organizata për iniciativën qytetare, Osijek, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

Artikulli 6.

Përfaqësimi

1. KOMRA-në e përfaqëson kryetari apo kryetarja e KOMRA-së
2. KOMRA mund të vendos që të përfaqësohet nga ndonjë anëtarë ose anëtare.

Artikulli 7.

Përdorimi i gjuhës

PJESA III – OBLIGIMI I BASHKËPUNIMIT ME KOMRA - në

Artikulli 8.

Obligimi i bashkëpunimit të shteteve me KOMRA-në

1. Të gjitha organet e pushtetit në shtete nënshkruese të marrëveshjes janë të obliguara që të bashkëpunojnë me KOMRA-në dhe të mundësojnë që t`a kryej në mënyrë efikase dhe efektive kompetencat e saj.
2. Organet kompetente në shtetin nënshkrues do të sigurojnë sipas kërkesës së KOMRA-s qasje në të dhëna (në përputhje me dispozitat ligjore të atij shteti).

PJESA IV – QËLLIMET E KOMRA-së

Artikulli 9.

Qëllimet e KOMRA-së

KOMRA ka këto qëllime:

- a) Vërtetimi i fakteve mbi luftërat/konfliktet e armatosura, mbi krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të Drejtave të Njeriut të kryera në territorin e RSFJ-së në periudhën nga 01. Janari 1991 deri më 31. dhjetor 1999.
- b) Kontribut në zbardhjen e fatit të të zhdukurve;

Koment:

Të burgosurit e kampeve të përqendrimit mendoj se është grup i cili vlenë që të vendoset në këtë kontribut për zbardhjen e fatit të këtyre njerëzve. Pra edhe këtë kisha propozuar që të jetë nën b) apo nën C). (Veselinka Kastratović, Qendra për paqe, jodhunë dhe të Drejtat e Njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik. 2010, Osijek, Kroaci).

- c) Pranimi i padrejtësive të shkaktuara ndaj viktimave dhe restaurimi i dinjitetit të tyre, krijimi i mekanizmit dhe zhvillimi i praktikës së ndjeshmërisë dhe solidaritetit;
- d) Kontribut në krijimin e besimit ndërmjet popujëve, mes individëve dhe shteteve të shkaktuar pas shpartallimit të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe kontribut për paqe të përhershme dhe stabilitetit në rajon;
- e) Kontribut afirmimit të demokracisë dhe kulturës së Drejtave të Njeriut përmes punës së mëtutjeshme në ngritjen e përgjegjësive të institucioneve juridike dhe politike, mediave dhe sistemit arsimor në shtetet nënshkruese të marrëveshjes.

PJESA V – ANËTARËT DHE ANËTARET E KOMRA-së

Artikulli 10.
Përbërja e KOMRA-s

[*Opsioni A – rekomandimet e grupit punues*]

KOMRA përbëhet nga 20 anëtarë ashtu që:

- a. Bosna dhe Hercegovina zgjedh pesë anëtarë apo anëtare;
- b. Kroacia, Kosova dhe Srbija zgjedhin nga tre anëtarë apo anëtare;
- c. Mali i Zi, Maqedonia dhe Sllovenia zgjedhin nga dy anëtarë apo anëtare;

[*Opsioni B*]

KOMRA përbëhet nga 21 anëtarë, nga të cilët secili nga shtetet nënshkruese të marrëveshjes zgjedh nga 3 anëtarë apo anëtare

Artikulli 11.

Pavarësia dhe asnjënia e anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-së

Anëtarët dhe anëtalet e KOMRA-s veprojnë në emër të vet në mënyrë të pavarur dhe asnjënis.

Artikulli 12.

Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-së

1. Anëtarët dhe anëtalet e KOMRA-s janë shtetas dhe shtetase të shteteve nënshkruese të marrëveshjes.
2. Anëtarët dhe anëtalet janë personalitetet me vlera të larta morale, me integritet dhe renome, të përkushtuara ndaj dialogut tolerant dhe ndaj zgjidhjes konstruktive të konflikteve, të cilët mund të gëzojnë besimin e popullit në të gjitha shtetet nënshkruese të marrëveshjes.

Koment:

Përpos çështjes e cila është e natyrës praktike që të jemi shtetas apo shtetase..por e gjithë kjo „me vlera të larta morale“ etj, mos e zëni për të madhe por këto janë shumë kritere fluide. E duke pasur parasysh se kjo do të bazohet në një lloj marrëveshje ndërkombëtare atëherë çka do të jetë aty ai kriter, burim i fakteve për atë çka ne këtu dëshirojmë.

(Branislav Vorkapiq, Organizata për iniciativën qytetare, Osijek, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

Te artikulli 12, pika 2, do të mjafton që të shkruhet se të gjithë anëtarët dhe anëtarët janë personalitete me autoritet dhe integritet të përkushtuara ndaj dialogut tolerant dhe zgjidhjes konstruktive të konflikteve dhe asgjë tjetër.. (Slavko Kecman, Shoqata për paqe dhe të Drejta të Njeriut, Bile, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik. 2010, Osijek, Kroaci).

3. Anëtarët dhe anëtarët e KOMRA-s janë të aftë në mënyrë psiko-fizike dhe kanë përgatitje të lartë profesionale

Koment:

Aftësitë psiko –fizike, mendoj se këtë duhet larguar nga teksti. (Slavko Kecman, Shoqata për paqe dhe të Drejta të Njeriut, Bile, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik. 2010, Osijek, Kroaci).

Mendoj se do të ishte më mençur që përpos përgatitjes së lartë profesionale, ku unë ende e mbaj mendimin tim se kjo nuk do të thotë asgjë, por një nga kriteret që njerëzit të kenë eksperiencë të caktuar, çka mund si burim i fakteve të rregullohet në mënyrë kompetente. (Branislav Vorkapiq, Organizata për iniciativën qytetare, Osijek, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

4. Çdo shtet nënshkruar i marrëveshjes zgjedh së paku një grua për anëtare të KOMRA-s.

Koment:

Mendoj se do të duhej që në këtë artikull të shkruaj se do të zgjidhet së paku një femër dhe së paku një mashkull. Të mos jenë aty të gjitha, ngase aty shkruan së paku një grua që të gjithë anëtarët mund të jenë të gjitha gratë. (Vesna Nediq, Oaza, Beli Manastir, Kroaci, Konsultimet me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

5. Për anëtarë ose anëtare të KOMRA-së nuk mund të zgjidhen personat për të cilat ekziston dyshim serioz se në çfarëdo mënyre janë përgjegjëse për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare apo janë të lidhur ngushtë me persona të cilët janë përgjegjës apo janë nën hetime për vepra të tilla, e gjithashtu nuk mund të jenë as personat të cilët kanë mbështetur apo inkurajuar kryerjen e veprave të tilla.

Koment:

6. Për anëtarë ose anëtare të KOMRA-së nuk mund të zgjidhen personat për të cilat.. le t'i lejmë këto elemente subjektive, këto çështje i zgjidhin prokuroritë, e jo ne,.. *në çfarëdo mënyre janë përgjegjëse për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare apo janë të lidhur ngushtë me persona të cilët janë përgjegjës apo janë nën hetime për vepra të tilla, e gjithashtu nuk mund të jenë as personat të cilët kanë mbështetur apo inkurajuar kryerjen e veprave të tilla.* (Slavko Kecman, Shoqata për paqe dhe të Drejta të Njeriut, Bile, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik. 2010, Osijek, Kroaci).
7. Për anëtarë ose anëtare të KOMRA-së nuk mund të zgjidhen politikan të shquar apo funksionarë publik ose personat të cilët e ushtronin këto detyra në kohën e cila përfshinë juridiksionin e KOMRA-s.

Artikulli 13.

Procedura e përzgjedhjes së anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-s

1. Çdo shtet nënshkrues i marrëveshjes do të përzgjedh anëtarët dhe anëtare të KOMRA-s në mënyrë siç është përshkruar në këtë artikull.
2. Kandidatin dhe kandidaten për anëtarë ose anëtare të KOMRA-së mund t'a propozojnë organizatat jofitimprurëse dhe institucionet ose 30 qytetarë të shtetit nënshkrues të marrëveshjes.
3. Procesin e kandidimit e kryen paneli seleksionues i cili i pranon dhe i kontrollon kandidaturat në raport me plotësimin e kushteve dhe e ngushton listën e cila përmban dy deri në tri herë numër më të madh të kandidatëve dhe kandidateve nga numri i anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-s të cilët përzgjidhen në shtetin nënshkrues të marrëveshjes. Paneli seleksionues dorëzon listën kryetarit/kryesisë së shtetit nënshkrues të marrëveshjes i cili kryen përzgjedhjen finale.
4. a. Paneli seleksionues përbëhet nga nëntë anëtarë të cilët duhet të plotësojnë kushte të njëjta të cilat vlejnë për anëtarët dhe anëtare të KOMRA-s, përpos

ndalesës së anëtarësimit për politikanët e shquar dhe për funksionarët publik ose për persona të cilët ushtronin këto funksione në kohën të cilën e përfshinë juridiksioni i KOMRA-s.

b. Anëtarë të panelit nuk mund të jenë kandidatët për anëtarë në KOMRA.

c. Tre anëtarë i emëron ministri për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat e pakicave, në konsultim me anëtarët e këshillit të kuvendit për të Drejtat e Njeriut. Anëtarët e koalicionit për KOMRA nga shteti nënshkruet i marrëveshjes kanë tre anëtarë të panelit seleksionues. Anëtarët e panelit kështu të përzgjedhur më tutje përzgjedhin tre anëtarë tjerë të mbetur në bazë të konkursit të cilin e shpallin në afat prej 8 ditësh nga dita e konstituimit të 2/3 të anëtarëve të panelit seleksionues.

e. Gjatë emërimit dhe përzgjedhjes së anëtarëve të panelit seleksionues, do të ketë kujdes që së paku të tretën e anëtarësisë t'a përbëjnë gratë dhe përfaqësues apo përfaqësuese të shoqatave të viktimave të cilat janë regjistruar së paku tre vite para nënshkrimit të kësaj marrëveshje duke përfshirë edhe shoqatat e viktimave të cilat nuk janë anëtare të koalicionit për KOMRA.

f. Procedura e përzgjedhjes së tre anëtarëve të mbetur të panelit seleksionues duhet të përfundoj në afat prej 60 ditësh nga data e hapjes së konkursit.

g. Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat e pakicave/ ministria e drejtësisë konfirmon përzgjedhjen e panelit seleksionues dhe siguron kushtet për punën e tij.

h. Paneli seleksionues në afat prej 8 ditësh nga dita e konstituimit të vet do të shpallë konkurs për kandidimin e anëtarëve të KOMRA-s.

i. Në afat prej 8 ditësh nga dita e mbylljes së konkursit, paneli seleksionues do të lajmëroj opinion mbi numrin e kandidaturave të pranuar, numrin e kandidaturave të cilat janë hedhur poshtë nga arsye formale dhe mbi numrin e kandidaturave që do të shqyrtohen.

j. Informatat mbi kandidaturat e pranuar, kandidaturat e hedhura poshtë dhe mbi kandidaturat të cilat do të shqyrtohen do të jenë të publikuara në web faqën e ministrisë për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat e pakicave/ ministrisë e drejtësisë.

k. Në afat prej 60 ditësh nga dita e mbylljes së konkursit, paneli seleksionues do të lajmëroj opinionin mbi listën e kandidatëve e cila do t'ju dërgohet Kryetarit/kryesisë së shtetit.

l. Paneli seleksionues mund t'i intervistoj kandidatët. Intervistat do të zhvillohen në prezencën e publikut.

5. a. Ditën e tridhjetë nga dita kur ju është dorëzuar lista nga ana e paneleve, kryetarët/kryesitë të shteteve nënshkruese të marrëveshjes do të informojnë njëri tjetrin mbi përzgjedhjet e tyre para se të informojnë opinion lidhur me këtë.
- b. Në afat prej 15 ditësh nga dita e informimit të të gjithë kryetarëve/kryesive të shteteve nënshkruese të marrëveshjes, kryetarët/kryesitë e shteteve nënshkruese të marrëveshjes do të lajmërojnë njëkohësisht opinionin mbi të gjithë anëtarët dhe anëtarët e përzgjedhura të KOMRA-së.
- Koment:
Unë nuk jam i sigurt se sipas Kushtetutës së Kroacisë kjo materie bie nën juridiksionin e presidentit sidomos nëse keni bërë krahasim me gjykatën e Hagës – kjo është diçka për çka vendos Qeveria e jo presidenti (Branislav Vorkapiq, Organizata për iniciativën qytetare, Osijek, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).
6. a. Anëtari apo anëtarja më e vjetër e KOMRA-s thirr seancën konstituive të KOMRA-s në afat prej 15 ditësh nga dita e përzgjedhjes dhe e kryeson këtë seancë në selinë e KOMRA-s
- b. Në seancën e parë konstituive anëtarët dhe anëtarët e KOMRA-s do të tentojnë që të përzgjedhin kryetarin/kryetaren e KOMRA-s dhe të aprovojnë rregulloren mbi punën e KOMRA-s.

Artikulli 14.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të bashkësive fetare

Gjatë përzgjedhjes së anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-s, shtetet do të orvaten që përbërja e Komisionit të jetë reprezentative, kështu që përpos përfaqësuesve të grupit më të madh etnik t'i kyç edhe përfaqësuesit e komuniteteve të tjera në atë shtet.

Koment:

Nuk mendoj se është me rëndësi nga se veç më janë të përfaqësuar përmes shteteve. Nëse përfaqësues janë për shembull të përkatësisë së pakicës serbe, aty është edhe Serbia dhe ashtu më tutje, por prapë se prapë është mirë që të gjinden, nga shkak i të tjerëve mu popullit minoritar të cilët nuk janë të përfaqësuar shteteve nënshkruese të marrëveshjes. (Draga Solar, Documenta, Zagreb, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-s, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

8. *Do të ishte mirë që në secilin shtet, pra në ish republikat e Jugosllavisë, ndoshta të jetë një pjesëtarë por jo pjesëtarë, që i thonë i popullit domicil, të themi*

konkretisht kroate, do të ishte pa lidhje që të jetë Serb, por do të ishte e nevojshme të jetë Hungarez. (Slavko Kecman, Shoqata për paqe dhe të Drejta të Njeriut, Bile, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik. 2010, Osijek, Kroaci).

Cilat pakica? E dini, a është kjo tash sipas atij kriteri pakica më e madhe apo pakica më e vogël etj. (Branislav Vorkapiq, Organizata për iniciativën qytetare, Osijek, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

Artikulli 15.

Betimi

Artikulli 16.

Të Drejtat dhe Detyrimet e anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-s.

1. Anëtarët dhe anëtares e KOMRA-së veprojnë me ndërgjegje dhe përkushtim, në mënyrë të pavarur dhe asnjëherë e cila nuk rrezikon në asnjë mënyrë integritetin dhe kredibilitetin e komisionit.
2. Anëtarët dhe anëtares e KOMRA-së janë të paguar për punën e tyre në përputhje me Aneksin 2 të Statusit.
3. Anëtarët dhe anëtares e KOMRA-së obligohen që të ruajnë sekretin e të gjitha informatave të cilat nuk janë fakte të njohura gjatë kohëzgjatjes së mandatit të KOMRA - së.
4. Obligimi i ruajtjes së sekretit zgjatë deri sa KOMRA nuk vendos që informatën ta publikoj përmes komunikatës zyrtare.

Artikulli 17.

Kuorumi dhe nxjerrja e vendimeve

1. Kuorumi i KOMRA-së për punë dhe marrjen e vendimeve është dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve dhe anëtareve.
2. KOMRA mundet që me dy të tretat e shumicës të vendos se për aprovimin e vendimit konkret procedural është e mjaftueshme që të ekzistoj shumica e thjeshtë e të gjithë anëtarëve dhe anëtareve.

Artikulli 18.

Imuniteti i anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-së

Artikulli 19.

Përfundimi i mandatit dhe shkarkimi i anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-së

1. a. Mandati i anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-s përfundon pas përfundimit të mandatit të KOMRA-s.

b. Anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-s ju ndërpritet mandati edhe në rast të dorëheqjes, vdekjes, kufizimit dhe humbjes së aftësisë së punës dhe në rast se dënohen me vendim të plotfuqishëm për vuajtjen e dënimit me burgim.

c. KOMRA do t`a konstatoj ndërprerjen e mandatit të anëtarit apo anëtares dhe për këtë do t`a informoj presidentin e shtetit/kryesinë, i cili/ e cila në afat prej 15 ditësh do të përzgjedh anëtarin apo anëtaresen e re të KOMRA-së nga lista të cilën paneli seleksionues e ka konfirmuar gjatë procedurës së propozimit të kandidatëve për anëtarë apo anëtare të KOMRA-së.
2. a. Presidenti/Kryesia e shtetit nënshkruet të marrëveshjes mundet që në bazë të propozimeve të shkarkoj anëtarin apo anëtaresen e KOMRA-së nga shteti në fjalë në rast të mospërbushjes së obligimeve të parapara me Status.
3. b. Propozimin për shkarkim të anëtarit apo anëtares e vërteton KOMRA, pa prezencën e anëtarit apo anëtares për të cilën anëtarësi vendoset.

c. Në rast të aprovimit të propozimit për shkarkim, presidenti/kryesia e shtetit përzgjedh anëtarin apo anëtaresen e KOMRA-së nga lista të cilën paneli seleksionues e ka konfirmuar gjatë procedurës së propozimit të kandidatëve për anëtarë apo anëtare të KOMRA-së.

PJESA VI – DETYRAT DHE JURISDIKSIONI I KOMRA-së

Artikulli 20.

Detyrat e KOMRA-së

Në mënyrë që ti vërtetojë faktet mbi luftërat/konfliktet e armatosura dhe mbi krimet e luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të Drejtave të Njeriut, KOMRA ka detyrë që:

1. Të mbledh informata dhe të ofrojë përshkrim të detajuar të rasteve të shkeljeve të të Drejtave të Njeriut, përkatësisht krimeve individuale dhe masovike të luftës;
2. Të mbledh të dhënat mbi fatin e të zhdukurve dhe të bashkëpunoj me organet përgjegjëse të cilët merren me kërkimin e të zhdukurve në shtetet nënshkruese të marrëveshjes;

Koment:

Më pas, në artikullin 20, do të kisha thënë, gjithashtu, nuk e di a është nën 2 apo nën 3, që të mblidhen të dhënat mbi fatin e të burgosurve, pra pësëri e kisha vendosur këtë grup. (Veselinka Kastratoviq, Qendra për paqe, jo dhunë dhe të Drejtat e Njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draftin e statusit të KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

3. përpilimi i listës së humbjeve në njerëz:
 - a. civilëve të cilët kanë humbur jetën apo janë zhdukur lidhur me konfliktet e armatosura;
 - b. luftëtarëve të cilët kanë humbur jetën apo janë zhdukur lidhur me konfliktet e armatosura;

Komentar:

9. *Vetëm te pika b) keni shkruar, luftëtarëve të cilët kanë humbur jetën apo janë zhdukur lidhur me konfliktet e armatosura. E dini, unë këtë e shikoj si një Konvencion mbi parandalimin dhe dënimin e krimeve, gjenocidit, dhe ndoshta kishte qenë më mirë të shkruhet pjesëmarrësve të konflikteve.* (Slavko Kecman, Shoqata për paqe dhe të Drejta të Njeriut, Bile, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik.2010, Osijek, Kroaci).

4. të mblidhen informatat mbi vendet e përqendrimit lidhur me luftën/konfliktin e armatosur, dhe të përgatit përshkrimin e tij detal;
5. të hulumtoj kontekstin, shkaqet, motivet dhe veprimet duke filluar nga viti 1980 të cilët kanë sjellë deri tek luftërat/konfliktet e armatosura, krimeve të luftës dhe shkeljeve të të Drejtave të Njeriut.

Artikulli 21.

Juridiksioni territorial dhe kohor i KOMRA-s

KOMRA vërteton faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljeve të rënda të të Drejtave të Njeriut të kryera në periudhën nga 01. Janari 1991 deri më 31. dhjetor 2001, në territorin e shteteve të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) si dhe kushteve politike dhe sociale të cilat në periudhën nga 01. Janari 1999 deri më 31. dhjetor 1999 kanë kontribuar fillimit të luftërave /konflikteve të armatosura, dhe kryerjes së krimeve të luftës dhe shkeljeve të të Drejtave të Njeriut.

Artikulli 22.

Veprat nën Juridiksion të KOMRA-së

Shkeljet e të Drejtave me të cilat merret KOMRA përfshijnë, por nuk limitohen në:

- a. vrasjet e civilëve dhe të robërve të luftës;
- b. robërimi;
- c. arrestime joligjore;
- d. deportimet dhe zhvendosja me dhunë e popullatës ;
- e. dhunimet dhe forma tjera të rënda të abuzimeve seksuale;
- f. torturat dhe sjelljet tjera johumane me të cilat në mënyrë të qëllimshme shkaktohej vuajta;
- g. zhdukjet e dhunshme;
- h. grabitja dhe shkatërrimi i pasurisë në suaza të mëdha;
- i. marrja peng;
- j. shkatërrimi i objekteve religjioze dhe kulturo - historike;
- k. shfrytëzimi i civilëve dhe të burgosurve të luftës si “ mbrojtës të gjallë”.

PJESA VII – AUTORIZIMET E KOMRA-së

Koment:

Mua më duket se autorizimet me të cilat përfundimisht KOMRA ishte dashur të merret do të kërkojnë që në shtetet anëtare të vjen deri tek një rregullativë juridike e cila

sipas karakterit, nuk e di si, vetëm sipas ligjit apo përmes ndonjë dokumenti ligjor për të ekzekutuar. (Branislav Vorkapiq, Organizata për iniciativën qytetare, Osijek, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

- Artikulli 23.

Marrja e deklaratave

1. KOMRA ka autorizim që të merr deklarata nga viktimat, dëshmitarët dhe nga qytetarë tjerë mbi krimet e luftës dhe shkeljeve të të Drejtave të Njeriut nga juridiksioni i KOMRA-së.

Koment:

Tek personat fizik, mendoj se do të jetë çështje e vullnetit tek personat të cilët dëshirojnë ose jo që të marrin pjesë në një proces të këtill në kuptim të dhënies së deklaratave. Në këtë kuptim mendoj se do të duhej që tektualisht kjo të jetë më e theksuar. (Branislav Vorkapiq, Organizata për iniciativën qytetare, Osijek, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

2. Deklaratat do të mblidhen:

- a. Në vendin ku jeton personi i cili jap deklaratë;
- b. Në zyrat e KOMRA-së;
- c. Në ambasada dhe konsullata të shteteve nënshkruese të marrëveshjes mbi KOMRA-në në rastin kur deklarata merret në shtetet e treta;
- d. Në territorin e shteteve të treta, nëse kjo nuk bie në kundërshtim me rregullat ligjore të atyre shteteve (në rastet kur viktimat, dëshmitarët dhe personat tjerë nuk mund ti japin deklaratat në konsullatat dhe ambasadat e shteteve nënshkruese të marrëveshjes).

Artikulli 24.

Mbledhja e dokumentacionit dhe burimeve të tjera

KOMRA ka autorizim që t'i mbledh burimet relevante të shkruara dhe elektronike siç janë:

- a. dokumentacioni i institucioneve ndërkombëtare dhe vendore të mbledhura me qëllim të dokumentimit të krimeve të luftës zbulimin e kryerësve dhe zbardhjen e fatit të të zhdukurve apo për çfarëdo qëllimi tjetër;
- b. burimet e shkruara dhe elektronike ndërkombëtare dhe vendore (duke përfshirë, por edhe duke mos u kufizuar në dokumentacionin e qeverisë, parlamentit, kryesisë, qeverisjeve lokale dhe territoriale, kompanive private dhe publike, ushtrisë, policisë, shërbimeve të informimit dhe sigurisë);
- c. aktgjykimet, transkriptet, shënimet gjyqësore të Tribunalit ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, të gjykatave kombëtare në shtetet nënshkruese të marrëveshjes dhe gjykatave tjera të cilat kanë gjykuar krimet e luftës të shkaktuara në territorin e ish Jugosllavisë në bazë të juridiksionit univerzal;
- d. materiali tjetër arkivor (i cili përfshinë certifikatat e vdekjes, raportet nga morgu, spitalet etj);
- e. burimet mediale të shkruara dhe elektronike;
- f. fotografitë, dhe audio, video incizimet;
- g. burimet tjera të lidhura me lënën e hetimit;
- h. opinionet e shkruara të ekspertëve, të përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave të përgatitura për nevojat e KOMRA-së;

- Artikulli 25.

Hulumtimet nga terreni

KOMRA ka autorizim që të vërtetojë faktet relevante përmes hulumtimeve në terren, vizitave të lokacioneve të krimeve, të vendeve të krimeve, varrezave individuale dhe kolektive dhe të gjitha lokaliteteve tjera që janë në interes të vërtetimit të fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të Drejtave të Njeriut.

- Artikulli 26.

Dërgimi i ftesës dhe kërkesës

1. KOMRA ka autorizim që të dërgojë ftesat për dhënien e deklaratave dhe dëshmime publike si dhe për kërkesat për dorëzimin e dokumentacionit, duke

përfshirë edhe dokumentacionin i cili është shpallur sekret e i cili ka të bëjë me periudhën e juridiksionit të KOMRA-së.

2. Ftesat dërgohen në bazë të ligjit në shtetin nënshkrues të marrëveshjes.
3. KOMRA mund të kërkoj dorëzimin e informatave me vendim të organit kompetent në shtetin nënshkrues të marrëveshjes. Nëse institucioni kompetent i dorëzon informatat e tilla, atëherë KOMRA ka obligim të rruajtjes së sekretit.
4. Të gjitha dokumentet të cilat shtetet nënshkruese të marrëveshjes i kanë dorëzuar Tribunalit Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë dhe janë përdorur në procedurat para këtij gjyqi pa përdorimin e ndonjë mase të caktuar për rruajtjen e sekretit do të trajtohen si dokumente publike.

Artikulli 27.

Mbajtja e dëgjimeve publike të viktimave dhe personave tjerë

1. KOMRA mban dëgjime publike në të cilat viktimat mund të njoftojnë publikun e gjerë mbi pësimet e tyre dhe pësimet e të afërmeve të tyre. Dëgjimet publike të viktimave janë vullnetare.
2. Dëgjimet publike mund të përfshijnë edhe dëgjimet e dëshmitarëve të krimeve të luftës, respektivisht të shkeljeve të tjera të rënda të Drejtave të Njeriut, dëgjimet e kryerësve të veprave që kanë karakter të krimeve të luftës apo të shkeljeve të tjera të rënda të Drejtave të Njeriut, si dhe dëgjimet të personave të cilët kanë ndihmuar viktimave apo me sjelljet e tyre kanë kontribuar që personi t'i shmanget mundësisë për t'u bërë viktimë e krimeve të luftës, respektivisht të shkeljeve të tjera të rënda të Drejtave të Njeriut.
3. Gjatë dëgjimeve publike KOMRA mund të ndërmerr masa të mbrojtjes së identitetit si dhe masa të posaçme mbrojtëse të integritetit psiko fizik.
4. Mediat elektronike në pronësi shtetërore, gjegjësisht shërbimet publike në territorin e ish RSFJ-së kanë për obligim që të transmetojnë dëgjimet publike. Mediat elektronike komerciale kanë të drejtën e transmetimit të dëgjimeve publike, në të njëjtat kushte dhe rregulla të cilat vlejnë për mediat në sektorin shtetëror gjegjësisht shërbimet publike.
5. Dëgjimet publike mund të mbahen në lokacione të ndryshme.

Artikulli 28.

Mbajtja e sesioneve tematike

1. KOMRA mban sesione në të cilat analizon veprimtarinë e institucioneve shtetërore, të organizatave politike dhe kulturore, të bashkësive fetare dhe të mediave në raport me kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të Drejtave të Njeriut.
2. Mediat elektronike në pronësinë shtetërore, gjegjësisht s shërbimet publike, në territorin e ish RSFJ-së kanë për obligim që t'i transmetojnë sesionet tematike të KOMRA-së.
3. Sesionet tematike mund të mbahen në lokacione të ndryshme.

Artikulli 29.

Metodologjia e punës gjatë marrjes së deklaratave, mbledhja e dokumentacionit dhe organizimit të dëgjimeve publike të viktimave dhe personave tjerë dhe sesioneve tematike.

1. Gjatë marrjes së deklaratave, mbledhjes së dokumentacionit, organizimit dhe zhvillimit të dëgjimeve publike dhe sesioneve tematike, KOMRA aplikon një metodë unike.
2. KOMRA sjellë rregulloren e posaçme me të cilën rregullon metodologjinë unike për marrjen e deklaratave dhe mbledhjen e dokumentacionit.
3. KOMRA sjellë rregulloren e posaçme me të cilën rregullon procedurën e dëgjimeve publike dhe sesioneve tematike.

PJESA VIII - STRUKTURA E KOMRA-së

Koment:

Unë kur e vështroj këtë draft dhe sa më shumë që e analizoj në detale atëherë më duket kaotike dhe kisha pasur dëshirë të shoh një diagram në përputhjeje me këtë draft, që të shihet se çka ka lart. Për shembull thuhet anëtarë dhe anëtare këtu në draft a do të jenë persona profesionalisht të punësuar?. OK. Çka nënkuptohet me mekanizmin udhëheqës? Çka do të thotë kjo? Çka kjo përcakton në mënyrë strategjike? Pastaj, shoh më tutje këto anëtare dhe ku janë ato në këtë skemë? Atëherë kemi disa ekipe hetuese e pastaj sekretariatit ekzekutiv i cili ka degë të ndryshme. Çdo nëndegë ka nga një udhëheqës dhe dikush duhet të punojë në këtë nëndegë diçka. Kështu që, kur unë tentoj ta parafytyroj një pamje më të qartë më duket mjaft kaotike. Çka do të punojnë 20 anëtarë/anëtare pasi kemi këto ekipe hulumtuese? Branislav Vorkapiq, Organizata për iniciativën qytetare, Osijek, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

Artikulli 30.

Organet dhe departamentet tematike të KOMRA-së

1. KOMRA themelon zyrën qendrore në Sarajevë, me emrin Sekretariati Ekzekutiv, detyra e së cilës është të ofroj anëtarëve të KOMRA-së mbështetjen teknike, administrative dhe operative dhe të koordinoj punën mes departamenteve të ndryshme dhe zyrave të cilat KOMRA do t'i themeloj.
2. Në kuadër të Sekretariatit Ekzekutiv ekziston një numër më i madh i departamenteve duke përfshirë departamentet për:
 - a. *financa;*
 - b. *hulumtime;*
 - c. *punë juridike;*
 - d. *mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve; ;*
 - e. *ndihmën psikologjike dhe këshillime për viktimat dhe dëshmitarët;*
 - f. *mbledhjen e deklaratave;*
 - g. *menaxhimin e dokumentacionit të KOMRA-së;*
 - h. *përgatitjen e Raportit Final dhe Përmbajtjes së Raportit;*
 - i. *arkivin;*
 - j. dhe departamente tjera të cilat KOMRA mund t'i themeloj sipas nevojës.
3. KOMRA ka të drejtë të përzgjedh dhe të emërojë Sekretarin Ekzekutiv si dhe shefat të departamenteve të lartpërmendura.

Artikulli 31.

Departamentet e KOMRA-së në shtetet nënshkruese të marrëveshjes

1. KOMRA do të themelojë zyrat në shtetet nënshkruese të marrëveshjes.

2. Zyrat në ë shtetet nënshkruese të marrëveshjes mund të themelojnë një ose më shumë zyre rajonale në vende tjera në territorin e shtetit nënshkrues të marrëveshjes në bashkëpunim me Sekretariatit Ekzekutiv, nëse çmojnë se kjo është e domosdoshme për kryerjen e punës.
3. KOMRA ka të drejtë të përzgjedhë dhe të emëroj shefat e ekipeve hulumtuese të cilët punojnë në kuadër të një shteti me rekomandim të zyrës në shtetin nënshkrues të marrëveshjes por në këtë rast mund të mos jetë i obliguar.
4. Zyrat në shtetet nënshkruese të marrëveshjes kanë drejtë që të themelojnë ekipet hulumtuese mobile në bashkëpunim me Sekretariatit Ekzekutiv të cilët në terren mbledhin të dhënat dhe informatat në kuadër të lëndës së hetimeve.
5. *(Statusi KOMRA-s në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në shtete tjera nënshkruese të marrëveshjes – zyrat rajonale – statusi i misionëve diplomatike?)*
6. Të punësuarit dhe bashkëpunëtorët në Sekretariatit Ekzekutiv, në departamente dhe zyre në shtetet nënshkruese të marrëveshjes dhe në ekipe hulumtuese angazhohen pa marrë parasysh shtetësinë.

PJESA IX – FINANSIMI I KOMRA-së

Artikulli 32.

PJESA X – RAPORTI FINAL I KOMRA-së

Artikulli 33.

Punimi dhe publikimi i Raportit Final

1. Në fund të mandatit të vet KOMRA publikon raportin mbi faktet e vërtetuara për konfliktet e armatosura, krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të Drejtave të Njeriut në territorin e ish RSFJ-së.
2. KOMRA i`u dorëzon raportin kryetarëve të shteteve nënshkruese të marrëveshjes dhe njëkohësisht e publikon raportin në të gjitha gjuhët zyrtare të shteteve nënshkruese të marrëveshjes.

3. KOMRA ka për obligim që njëkohësisht me dorëzimin e raportit final të bëjë të mundshëm që përmbajtja e raportit të jetë në qasje për opinionin.

Artikulli 34.

Përmbajtja e Raportit Final

1. Raporti do të përmbaj hyrjen, faktet relevante mbi luftërat/konfliktet e armatosura, krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të Drejtave të Njeriut, listën e humbjen në njerëz, listën e personave të zhdukur, listën e vendeve të mbajtjes dhe referencat.
2. Rekomandimet e KOMRA-së, në mes tjerash do të përfshijnë:
 - a. Hapat e mëtutjeshëm të shteteve nënshkruese të marrëveshjes për avancimin e besimit ndërmjet shteteve dhe komuniteteve në territorin e ish Jugosllavisë;
 - b. Modelin përkatës të reparacioneve materiale dhe simbolike, mënyrën për reformimin e institucioneve dhe mekanizmat me të cilët sigurohet integrimi i fakteve të vërtetuara në sistemet arsimore të shteteve nënshkruese të marrëveshjes në përputhje me Parimet themelore mbi të drejtën në medikamentin ligjor dhe reparacion për viktime të shkeljeve të rënda të të drejtave të Njeriut dhe të Drejtës ndërkombëtare humanitare të aprovuar me Rezolutën të Asamblesë Gjenerale të Kombeve të Bashkuara nr. 60/147 më 16. dhjetor 2005;
 - c. Mënyra e monitorimit të implementimit të rekomandimeve të KOMRA-s, përfshirë edhe themelimin e organeve të posaçme për këtë qëllim.

Artikulli 35.

Karakteret e gjeturave të KOMRA-së

Koment:

Ato të gjetura nuk mund të jenë karakter. Ato mund të jenë rëndësia e të gjeturave të KOMRA-së. Karakteri është më shumë i lidhur me njeriun, kjo është kategori subjektive, kështu që kjo nuk është e shkruar në mënyrë profesionale. (Slavko Kecman, Shoqata për paqe dhe të Drejta të Njeriut, Bile, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik. 2010, Osijek, Kroaci).

1. KOMRA nuk paraqet trup gjykues dhe për këtë arsye nuk e vërteton përgjegjësinë individuale penale për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të Drejtave të Njeriut.
2. Pa marrë parasysh kufizimet nga paragrafi i mëparshëm, KOMRA ka autorizim që në raportin final të vërtetojë që faktet e mbledhura tregojnë se personi i caktuar ka kryer krime të luftës gjegjësisht ka kryer shkelje të rëndë të Drejtave të Njeriut. Këto të gjetura nuk kanë efekt në aktgjykime gjyqësore.

Koment:

A janë këto, ndoshta shkelje të të drejtave të njeriut të këtij personi i cili në një mënyrë, pa marrë parasysh në relevancën e këtyre fakteve , në opinion të paraqitet si i zbuluar apo si kryes i ndonjë veprë për çka mundet vetëm gjyqi të vërtetojë a është kryer apo jo? (Branislav Vorkapiq, Organizata për iniciativën qytetare, Osijek, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

„Të gjeturat e tilla kanë efekt të aktgjykimit gjyqësor – kjo assesi nuk duhet të qëndroj, kjo nuk ka kuptim të shkruhet. Ngase kjo është normale. Nuk mund të ketë efekt. (Slavko Kecman, Shoqata për paqe dhe të Drejta të Njeriut, Bile, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-së, 13. korrik.2010, Osijek, Kroaci).

Gjithkush nga ne në mënyrë individuale, e kështu edhe KOMRA po që se është kryer vepër penale, pa marrë parasysh cila vepër, e në këtë rast vepër e krimeve të luftës, kjo atëherë duhet lajmëruar Prokurorisë shtetërore . Nuk ka dilemë aspak. Prandaj, të pritët raporti shtetëror, për mua është disi, nuk e di. Nuk më pëlqen kjo çka shkruan këtu. (Veselinka Kastratoviq, Qendra për paqe, jo dhunë dhe të Drejtat e Njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draftin e statusit të KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

3. Në pikëpamjen e rasteve që janë proceduar, në prezencën e të akuzuarit, para gjyqit ndërkombëtar apo vendor, KOMRA në raportin e vet mund të drejtoj kah aktgjykimi përkatës.

PJESA XI – TË NDYSHME

Artikulli 36.

Roli i KOMRA-së në procedimin penal

KOMRA ka autorizim që:

1. Të propozoj në rast se personi për të cilin KOMRA ka indikacione se ka kryer vepër të krimeve të luftës apo shkelje të rëndë të të drejtave të Njeriut të deklaroj KOMRA-s të dhënat me rëndësi për zbulimin e lokacionit me mbetjet mortore të të zhdukurve, apo për zbulimin të kryerësve tjerë, që kjo të merret nga gjyqi kompetent – në rast të procedimit – si rrethanë lehtësuese të një rëndësie të veçantë për përcaktimin e lartësisë së dënimit;

Koment:

Të ndikohet përmes rrethanave lehtësuese apo rënduese, kjo mund të jetë diçka çka nuk do të pëlqehet nga njerëzit e gjykatave dhe çka nuk shkon kah gjurmët e mira. (Veselinka Kastratović, Qendra për paqe, jo dhunë dhe të Drejtat e Njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draftin e statusit të KOMRA-së, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

2. Të propozoj personin e dënuar të veprës penale për falje të pjesërishtme nëse kjo nuk është në kundërshtim me me dispozitat ligjore të shtetit përkatës, nëse KOMRA publikon të dhëna me rëndësi për zbulimin e lokacionit me gjetjet mortore të të zhdukurve apo për zbulimin e kryerësve tjerë;

Koment:

Nëse flitet për atë që t'i jepet shansi KOMRA-s që dikë t'a propozoj, kryerësin e dënuar, e për falje të pjesërishtme, atëherë, cilat janë ato kritere të cilat do të vlerësohen se a mundet ky person apo jo. Pa këto kritere kjo nuk ishte dashur të figuroj këtu.. (Veselinka Kastratović, Qendra për paqe, jo dhunë dhe të Drejtat e Njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draftin e statusit të KOMRA-së, 13.korrik 2010, Osijek, Kroaci).

3. Të propozoj zvogëlim të jashtëzakonshëm të dënimit, nëse personi jap informata KOMRA-s mbi të dhënat me rëndësi për zbulimin e lokacionit me gjetjet mortore të të zhdukurve apo për zbulimin e kryerësve tjerë.

Koment:

Unë filloj nga artikulli 1. Definicioni është „vërtetimi i fakteve mbi krimet e luftës“ dhe tash mos t'a lexoj më tutje se çka do të thotë dhe vijë tek artikulli 36 – roli i KOMRA-s në procedimin penal. Tërë kohën mendoj se çka në fund, le të themi që

komisioni e kryen këto punë të parapara me artikullin 36 - pra të propozoj kryerësin e dënuar për falje të pjesërishtme, zbutje të dënimit dhe kështu me radhë dhe pra vetëm propozon. Kjo mua nuk më pëlqen dhe mendoj se mandati i komisionit nuk është për diçka të tillë dhe frikohem që puna e komisionit do të zhvlerësohet në mënyrën se si individët do t`a shikonin këtë punë. Përherë dikujt kjo nuk do t`i pëlqej. Unë do të kisha lënë që gjykatat të kryejnë punën e tyre e komisioni të mbetet në kuadër të mandatit të përshkruar në definicion. (Draga Solar, Documenta, Zagreb, Kroaci, Konsultimet lokale me organizatat e shoqërisë civile mbi draft statusin e KOMRA-s, 13. korrik 2010, Osijek, Kroaci).

Artikulli 37.

Mbrojtja e burimeve dhe dokumenteve sekrete

Të gjithë anëtarët dhe anëtarët e KOMRA-së, si dhe të punësuarit në KOMRA obligohen që të ruajnë sekret të gjitha informatat të cilat zbulohen në kuadër të punës së KOMRA-së, përpos në rastin kur KOMRA vendos që atë informatë ta publikoj në formën e komunikatës zyrtare.

PJESA XII – DISPOZITË PËRFUNDIMTARE

Artikulli 38.

SHUARJA E KOMRA-së

Artikulli 39.

Arkivi i KOMRA-së

Artikulli 40.

Themelimi i trupit mbikëqyrës mbi aplikimin e rekomandimeve të KOMRA-së